



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIC OF KOSOVO  
REPUBLIKA KOSOVA



KOMUNA E PEJËS / MUNICIPALITY OF PEJA / OPŠTINA PEĆ

**KUVENDI I KOMUNËS PEJË**

**I.Numër: 060/01-76382**

**Pejë, datë: 27 Shtator 2024**

**PROCESVERBAL**

Nga takimi i –VIII- të i rregulltë i Kuvendit Komunal Pejë, i mbajtur me: **27 shtator 2024**, me fillim në orën 10:00 h.

Takimi u mbajt në sallën e Kuvendit të Komunës së Pejës.

Në takim prezantojnë: pos anëtarëve të kuvendit të komunës, kryetari i komunës z. Gazmend Muhaxheri, nënkryetari z. Fatmir Asllani; kryesuesi z. Rexhep Kurtbogaj; drejtorët e SHCK-së, z.Avni Gashi, udhëheqës i sektorit të kuvendit, zyrtare administrative znj.Donjeta Morina,: përfaqësues të ZIP-it, përfaqësuesit të OJQ-ve dhe përfaqësues të mediave të shkruara dhe elektronike.

Në vazhdim takimin e kryesoi; kryesuesi z. Rexhep Kurtbogaj, ku e hapi diskutimin për rendin e ditës dhe i sqaroi pikat të cilat janë vendosur në rend dite, pastaj konstatoj se janë 32 anëtarë prezent.

Nga të gjithë anëtarët prezent, me 31 vota pro, 1 anëtar nuk ka marr pjesë në votim u miratua ky rend dite me propozimin që u dha nga kryesuesi:

**REND DITE**

1. Pjesëmarrja në takim e anëtarëve të kuvendit dhe mungesat.
2. Pjesëmarrja publike dhe delegacionet.
3. Shqyrtimi dhe miratimi i Procesverbalit të K.K. Pejë, dt. 26.07.2024.
4. Shqyrtimi dhe rekomandimi për miratimin e buxhetit të Komunës së Pejës 2025-2027.
5. Shqyrtimi dhe miratimi i propozimit të Kryetarit të Komunës për këmbimin e pronës së paluajtshme Komonale me pronën private të z. Fatmir Zymberi, me qëllim të përmbushjes së interesit publik.
6. Shqyrtimi dhe miratimi i propozimit të Kryetarit të Komunës për këmbimin e pronës së paluajtshme Komonale me pronën private të znj. Ajmon Sefa, me qëllim të përmbushjes së interesit publik.

7. Shqyrtimi dhe miratimi i propozimit të Kryetarit të Komunës për këmbimin e pronës së paluajtshme Komunale me pronën private të z. Sali (Shaban) Qelaj, me qëllim të përmbushjes së interesit publik.
8. Shqyrtimi dhe miratimi i propozimit të Drejtorisë së Administratës dhe Kryetarit të Komunës së Pejës për kompensimin e kryesuesve të Këshillave Lokale për vitin 2023 dhe 2024.
9. Shqyrtimi dhe miratimi i propozimit të Kryesuesit të Kuvendit të Komunës së Pejës për kompensimin e Komiteteve Konsultative për vitin 2023 dhe 2024.
10. Shqyrtimi dhe miratimi i propozimit të Kryetarit të Komunës së Pejës për kompensimin e anëtarëve të KKSB-së për vitin 2023 dhe 2024.
11. Shqyrtimi dhe miratimi për dhënie në diskutim publik të Draft –Planit të Veprimit kundër braktisjes dhe mosregjistrimit të shkollës, 2024-2026.
12. Shqyrtimi dhe miratimi për dhënie në diskutim publik të Draft Rregulloren për Shërbimin e Transportit me Marimangë në territorin e Komunës së Pejës.
13. Shqyrtimi i informatës nga DKA për fillimin e vitit shkollor
14. Pytjet dhe propozimet lidhur me punën e Komunës, të ngritura nga anëtarët, në atë rënditje siç janë pranuar:
15. Çështje të ngritura në mbledhje nga udhëheqësi apo nga anëtarët e Kuvendit.

#### **1.Pjesëmarrja në takim e anëtarëve të kuvendit dhe mungesat.**

Në takim munguan z. Rrustem Berisha dhe z.Drin Veselaj.

#### **2.Pjesëmarrja publike dhe delegacionet.**

Nuk ka pasur.

#### **3.Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të Kuvendit të Komunës së Pejës dt. 26.07.2024).**

Nga të gjithë anëtarët prezent me 30 vota pro, 1 anëtar nuk kanë marr pjesë në votim, miratohet procesverbali i dt,26.07.2024, me vërejtjet që u dhanë nga znj.Hidajete Krasniqi.

#### **4.Shqyrtimi dhe rekomandimi për miratimin e buxhetit të Komunës së Pejës 2025-2027.**

**Kryesusi Z. Rexhep Kurtbogaj:** Pasë ndjekjes së procedurave nga ekzekutivi, diskutimeve publike të thirrura nga kuvendi, është bërë plani i buxhetit, tani kemi ardhur tek vendimi final për miratim.

**Z. Labinot Panxha:** Po diskutohet për planifikimin e buxhetit për vitin 2025-2027, për dijënin e qytetarëve sepse ne këtu të gjithë e dimë se si ka shkuar. Komuna e Pejës ka planifikuar një buxhet që do të shërbëjë vetëm partisë në pushtet dhe atë për zgjedhjet qendrore dhe lokale të cilat do të mbahen në shkurt dhe në tetor të vitit 2025. Pse e themë këtë, duke u bazuar në orjentimin e buxhetit i cili është i orjentuuar vetëm kah elektorati që partia në pushtet e ka dhe jo edhe kah investimet, kërkesat dhe nga nevojat e qytetarëve, të cilat janë të shumta. Ajo që me ka renë në sy tek investimet kapitale, ishin projektet që kanë qënë të planifikuara dhe kanë filluar të punohen në vitin 2024, mirëpo të njëjtat qenkan planikuar të kryhen edhe në këtë planifikim buxhetor për

vitin 2025-2027. Pra është fjala për asfaltimin e rrugëve në qytet dhe fshatra të cilat kanë filluar dhe qytetarët po ankohen, sepse nuk po shkon askush mi kry. Është fjala për ndertimin e disa trotuarëve që veq kanë fillu dhe kanë mbet ashtu. Edhe disa projekte të tjera që kanë qenë poashtu, po e ritheksojë edhe njeherë në buxhetin e kaluar, mirë po të njejtat janë të planifikuara edhe në këtë buxhet që sot e keni sjellë për aprovim. Pra ky planifikim buxhetor po e dëshmon që komuna është në borxhe të medha. Tjetër, që jeni kaq të uritur dhe nuk doni mu ngi as në mandatin e tret dhe të fundit, e tregon fakti së në këtë planifikim buxhetor, i keni planifiku dreka, darka si dhe udhetime jashtë vendit se 300.000 euro. Unë, mendojë që kjo nuk është vetem uri, po është edhe uri me abuzu me taksën e qytetarit. Në vend që këto shpenzime të ishin përgjysmu dhe të njejtat t'ju kishin kthy qytetarëve, në investime apo projekte të cilat ata i kanë propozu vite me radhë, apo ti orjentoni në përkrahjen e studenteve përmes ndarjes së bursave vjetore, pra ky pushtet zgjedh për të abuzu me to! Tjetër që është e rëndësishme për Lugun e Baranit, është që nuk keni planifiku as edhe një euro të vetme për realizmin e projektit të ujësjellesit dhe furnizimin me ujë të pishëm për ata banor. Po behen gati 12 vite prej kur ka filluar ky projekt dhe ende nuk është perfundu, vërtet po luani me ndjenjat e atyre banorëve, çdo fushatë zgjedhore shkoni dhe i mashtroni se kinse këtë vitë ose vitin tjetër kemi me jau sjell ujë të pishëm në shtëpit tuaj, e ne fund nuk e planifikoni as një euro për realizmin e atij projekti, përveç së të thoni se dikush nga opozita po e pengon realizmin e projektit në fjalë, e për mua poashtu edhe për ata banor është i pa pranueshem një justifikim i tillë në lidhje me këtë temë. Singërisht në lidhje me këtë temë unë e ndjej një obligim moral që prej kësaj foltore me ju kërkua falje të gjithë banorëve të Lugut të Baranit, që për këto vite të mandatit tim si asambleist opozitar, nuk kam mundur të ndikojë tek qeverisja komunale për ta sjellur ujin e pishëm në shtëpit e tyre. E një kërkim falje gjithashtu j'au ka me borxh fajtori kryesor për këtë gjendje që është Gazmend Muhaxheri, pra kryetar kish qen mirë me kërkua falje edhe ti, dhe mos me u justifikua se kinse dikush po të pengon me realizu këtë projekt. Ose po ta bëj një propozim për me kuptu gjithë, le të shkonë dhe ta kyç gypin tek burimi i drinit në Radavc, dhe mos i shikua interesat polike po shikojë interesat e banorëve. Nese ky shkon e kap grypin tek burimi i Radavcit, dhe ata e kërcënojnë me dalje prej kualicionit apo nuk e votojnë atë që ky e sjellë në kuvend, para juve po e them, fjalë publike po e jap, kam me e mbeshtetë sa te jem ne kuvend, unë dhe koleget e mij sa të jemi këtu. Krejt në fund dua të them se sikur taksat e qytetarëve të menaxhoheshin në mënyren më të mirë të mundshme, të shperndaheshin në mënyren e drejt dhe jo diskriminuese, ku do të plotësoheshin kërkesat e tyre dhe të njejtat do të ndikonin në mirëçenjen dhe zhvillimin ekonomik të komunës tonë, me shumë knaqësi do ta kishit edhe voten e Aleancës sot për ta kaluar buxhetin, por përderisa ju zgjedhni të abuzoni dhe keq menaxhoni me taksën e qytetarit nuk e keni mbështetjen e as votën tonë!

**Kryetari Z. Gazmend Muhaxheri:** Së pari po ta kthejë përgjegjjen për ujësjelles, nuk është planifikuar buxheti për vitin tjetër sepse përfundohet këtë vitë. Nuk po lejne me e përfundu shpijunat që e thirrin prokurorin 10 herë në ditë dhe mendoni që mundeni me e arrestu Gaz Muaxherin. Të hënë të ftojë me ardh me kryetarin tek prokurori me shku dhe e shikojmë këtë punë siç është, ju jeni ata që e gjuani gurin dhe e mshefëni dorën, unë kur nënshkruaj diçka i dalë

përballë. Tash po të them qe mbas të hënës, të martën, punëkryesi ka me dalë me punu atje, e mundoheni me e ndalë, e me arrestu Gazmend Muhaxherin me prokuror dhe me sende që i bëni shprijunazh. Atë që po e thu për me lidhë në Drinin e Radavecit, është dashtë me ja thenë kryetarit tënd kur e ka nisë projektin, sepse është dashtë mu nisë prej Drinit e me u lëshu të poshtë, e jo prej Nepoles mu ngjitë përpjetë. Ateherë ky projekt është berë për vota, jo kjo që po bëj unë që spo mundem me e kry projektin qe 10 vite se e keni nisë mbrapshtë. Të gjitha projektet që janë në interes për komunën jemi duke i kryer. Pë dreka, darka, mos spekuloni me fjalë të atyre që jau shkruajnë fjalimet, nuk janë as 60.000 euro, dhe kryesisht janë dreka, darka për sportista që duhet me i prit musafirtë e tyre, shkonë edhe diçka për musafirtë tonë, se nuk mundesh me i prit pa dreke e darka, por as 60.000 euro nuk i arrinë, do të thotë ajo nuk është e saktë është shpikje.

**Z. Labinot Panxha:** Kryetar po bëhet fjalë për buxhetin 2025-2027 dhe unë flasë në tërsi, 100.000 euro i ki vetem tek DKRS, ti vet i ki 70.000 euro për mi shpenzu. Kush jemi në të tregova në foltore, të ofrova bashkëpunim, vetëm lejë interesat politike, që ku na ke për me bashkëpunu me qu ujin në Lugë të Baranit. Kush ka shpjonu ka emër e ka mbiemër, nesë dikush ka shku prej Aleancës thuaja këtu emrin, po nuk është e vertetë, edhe këtu po mundohesh me manipolu. Po ashtu, kur ka filluar projekti na e kemi humb pushtetin, ti e ki fitu, ti e ki gjetë në gjysmë të Lugut Baranit të shtrimë rrjetin e ujit, gjithmonë shtrihet rrjeti dhe pastaj kyçet, nuk shkon më u kyç njëherë, se kur të kyçet vazhdon të poshtë uji dhe nuk të len me punu. Ti e din sepse je inxhinier në këtë punë, nuk po të përzina në punen tendë, mirëpo me manipulu në këtë formë, kjo është bash fushatë elektorale, fushata fillon në janar, nuk është sot. Unë. po i rri mbas asaj që e thash, nuk është askush që të ka qu në prokurori, e ke qu veten , njejtë po don me të ndodhë si për Boren!

**Kryetari Z. Gazmend Muhaxheri:** Krejt bota e dinë që kanalizmet shkojnë prej fundit e ujësjellsat prej sipër, të kishit nisur ju prej se naltit, Lugut Baranit kishte qën tu shku uji e ndoshta kish mbet Nepolja pa u kry, po e keni nisë të kundertën se ka qenë fushat zgjedhore. Për këtë punën e prokurorisë, që 15 ditë operatorit i është ndalë puna. E ti hajde të hënën me mu, po shkojmë të kryeprokurori po flasim me të dhe e sheh çka është tu ndodhë. Do thotë ka mbetë veç hinka për mu lidhë uji në Lugë të Baranit e mu lëshu.

**Z. Berat Ganiqi:** Si për çdo vjet që vjen buxheti, LVV ka qënë i vetmi subjekt që nuk e ka votu për shkak sepse kanë munguar subvencionet dhe përkrahja e qytetarëve, sikur po ndodhë në komnatat e tjerat. Komuna e Pejës është e vetmja që nuk e përkrahë as qytetarët e as bizneset e vogla, as asgjë tjetër, përposë që krijon një buxhet që i shërben për vazhdim të mandatit. Sot po shihet që komuna e ka një drejtoreshë të financave , por ajo kurr ska ardh prezent në asnjë mbledhje. Zakonisht dergohet zyrtarja kryesore financiare për me mbrojtë një buxhet që është përpilu, do të thotë komuna e Pejës është e braktisur së pari prej drejtoreshës së financave. Tri vite në Pejë ka pasur pushim të punimeve, ndersa në vitin e katërt, në vitin e zgjedhjeve kemi një pretendim qe deshirojmë të punojmë sa më shumë për ta vazhduar mandatin e katërt. Mos subvencionimi i qytetarëve të Pejës, mos përkrahja e bizneseve dhe gjërave tjera, sikur po ndodhë në komuna tjera, këtë buxhet e bën më shumë për kryetarin se sa për qytetarin. Ky

buxhet edhe në vazhdimsi ka me vazhdu, edhe ka me vepru njejtë sikur është vepruar në të kaluarën. Për militantin asfalti deri në oborr ose deri në pragë të derës, ndersa për qytetarin 1 meter gropë midisë qendrës së qytetit. Kjo është e pa tolerueshmë dhe si LVV ne do të votojmë kunder ashtu siç kemi vepruar në gjithë këtë mandat. Kryetari sot për herë të parë e pranojë, me dashje a pa dashje, që LVV nuk e ka pengu në projekte, e tha vetë. Na mundemi këtu të themi çfarë të duam mirëpo realiteti është ky, një shesh që për 12 vite nuk ka përfunduar, pritet të përfundojë tani në mandatin e tretë, në fund të mandatit. Një ujësjellës që është që është premtuar qysh në fillim dhe pritet të përfundojë në mandatin të tretë. nese do të përfudojë dhe ndriqimin të cilin e keni reklamuar, se sot gjysma e Pejës prap vazhdon pa ndriqimin edhe pse shtyllat elektrike janë, ndersa poçat elektrik nuk punojnë fare, andaj këto janë arsytet që në vazhdojmë të jemi kunder votimin të këtij buxheti.

**Kryetari Z. Gazmend Muhaxheri:** Unë, Berat e pata vetëm për ujësjellsin e Lugut të Baranit, që nuk jemi ra në grackën e tyre, por tani po ju tregojë edhe asmableistave edhe qytetarëve të Pejës, i keni nda 1.200.000 euro në Ministrinë e planifikimit hapsinorë për me vazhdu lumin deri te implianti për pastrimin e ujrave të zëza, është viti i dytë që së keni qit tenderin, kjo është ministria ku ti je këshilltar me duket. E keni pas trotuarin prej Patrikanës deri tek tunelli 2 metra për biçiklista, e keni hek se kanë thënë njerëzit po fiton kryetari vota, nese fitohen votat me projekte siç po mendoni ju, pse nuk e keni berë ju ka ministria me e qit tenderin. E keni shkollën fillore të cilën është dalë tenderi para 4 viteve, keni pasë me ritenderu, se keni ritenderu sepse po thoni që po fiton kryetari vota, dhe e keni shpallë armikun numer një të LVV, veç pse ju kam thënë një të vertetë. E keni rrugën Patrikanë – Kuqishtë, që 5 vite jeni në pushtet asnjë cent nuk e keni investu, e keni berë një prishje të rrugës, asfaltim që është prishë prap, e keni riasfaltu, kjo është çka këni berë për 5 vite për Pejën!

**Z. Berat Ganiqi:** Këtë formën e prezantimit të projekteve gjysmake, siç të konvenon ty është e pa drejtë, meqenëse këto që i the diçka qëndron, e diçka nuk qëndron. Te rrugët e Rugovës është nënshkru memorandumi që asnjë komunë, as LVV nuk i është nënshkru prej Ministrisë së Infrastrukturës, asnjë projekt i ri nuk ka hyrë, si kanë hyrë këto 3 rrugë. Prej MAPL-së çdo ditë e ki pasë përkrahjen dhe çdo ditë e ki pasë në takim, prej ministrisë së kultures e dinë qfarë investime, ato monamente trashigimore që ju edhe tjerët i patet kthy në autolajrje, sot po restaurohen edhe po punohen dhe po i kthehet dinjiteti atyre monomentëve kulturore. Për rrugën e Rugovës për me prish me temel me atë projektin e famshëm të KEDS-it, që ke invesuar 400.000.00 euro i ke jep, sot kqyre çka i kanë berë rrugës, as që e kanë kthyer në gjendjen që ka qënë e as kurgjo më shumë. Për firmën e cila e ka pasë fitu atë projekt për reregullim të rrugës, dihet ku ka përfundu. Kur të kryen drejtësia çeshtjen edhe kur ka shkuar si land, ne nuk mundemi firmën me e ngreh zhagë edhe me punu, është çeshtje e drejtësisë, drejtësia le ta kryen si rrugë. Në momentin që përfundon rruga e Rugovës do të rregullohet. Për Rugovë se çka është punu, del pyeti banorët prej Stankajve e të poshtë. Kjo qeveri thë së të ka shpallur armik, nuk është e vertetë, gjema një zyrtarë të LVV që ka thenë z.Gazmend Muhaxheri e kemi armik vetem një

deklaratë gjëjë çka dush ki vetem një deklaratë gjeje! Unë ty ti gjëjë 100 deklarata që e ke krahesuar me qeveri të Serbisë, tash për vota nuk e përdor këtë sepse të vyn për fushatë.

**Kryetari Z. Gazmend Muhaxheri:** Unë për tri rrugët e Rugovës kanë qenë në vazhdim dhe i keni qitë parat, unë ju kam falenderuar publikisht, por ato i kam tenderuar unë. Ajo që është përgjithësi ju me e kry, nuk jeni duke e kryer. Sa kam kryer unë për këto 4 vite mandat të komunës ju nuk keni kryer si qeveri. Parat që i janë ndarë komunës së Pejës, shikone kontrollone vetëm njëherë i kan dalë 1.600.000.00 euro, unë besoj që komunës së Pejës në bazë të numrit të banoreve i takojnë prej qeverisë së paku 5.000.000.00 euro me ja dhën në vjet shtesë. Por shkojnë në komunën e Shtimës 26.000.000.00 shtesë, shkojnë në Kamenicë. Ju keni premtu që keni me qeverisë ndryshe, ju keni ardh me drejtësi me qeverisë, po atë drejtësi nuk e keni treguar për banorët e Pejës në asnjë rast. Për pjesën tjetër kur më bjen me folë për të drejtën, unë nuk matem a marrë vota a nuk marrë vota, unë e foli atë që e mendoj dhe nuk heshti para të keqës me ditë që neser nuk e marrë asnjë votë, sepse nuk ka të bëjë e keqja me votën.

**Znj. Hidajete Krasniqi:** Me qenë se jemi duke e diskutuar buxhetin e vitit 2024-2025 unë jam muduar të ndalëm tek disa pika. Mjetet e parapara për përfaqesimin e avokaturës 50.000 euro, sukses shumë i vogël, duke pasur parasysh që shumica e lëndëve humbin në gjykatë. Tek adaminsitrat e shërbimeve kontraktuese me vlere 1.900.00 euro për cilat shërbime bëhet fjalë sepse nuk e keni cekur. Tek shërbimet publike hartimi i projekteve 195.000 euro, ndersa paga e mbikqyrësit të këtyre projektëve 50.000 euro, shumë e madhe, kush e zgjedhë këtë mbikqyrës dhe nga kush monitorohet? Tek kujdesi primar shëndetsorë për veshbathje për vitin 2025 nuk keni paraparë për puntorët shëndetsorë dhe pse nuk është paraparë? duke pasë parasysh që ka mjetë buxhetore, por ndoshta për ju shëndetsia anjëherë nuk po është prioritet. Te kujdesi shëndetsorë sigurimi i automjeteve 10.000 euro dhe regjistimi 10.000 euro, kemi përvojë në këto regjistime dhe sigurime sepse punojmë në instuticione shëndetsorë dhe mos është berë ndonjë gabim, sepse nuk e besojë që janë të nevojshme 20.000 euro vetëm për regjistimin dhe sigurimin e automjetëve te kujdesit parësorë po flasim, nese do të ishin për të gjithë komunën do të ishte e arsyeshme. Gjithashtu tek kujdesi primarë prap është paraparë qendra për edukimin e vazhdueshem profesional, qendra e trajnimeve në lagjën “2. Korriku”, nuk e kuptojë a është ndonjë gabim, sepse ne e dimë që për qender janë ndarë mijra euro, është në përfundim e sipër tek spitali e qe ajo qender duke mendu që ka me na shërby edhe neve si institucion, se lemo te kujdesit parësorë. Tek investimet kapitale prap nuk specifikohen rrugët e caktuara por vetem lokalitetet mendoj që mbetet në dëshiren e aktivistëve politike se ka dëshirojnë t’i orientojnë këto projekte. Edhe me keq tek drejtorati i bujqësisë cekën vetëm regjionet ku do të ndërtohen kanalët e ujitjës, përshembull Lugu i Baranit, Lugu i Leshanit, Lugu i Trestenikut, por nuk cekën fshatrat në të cilat do të ndërtohen këto kanale. Po ashtu 7.5 milion euro investohen në infrastrukturë, por për zhvillim ekonomik janë vetëm dy projekte të vogla, një për muze të bjeshktarisë dhe një për zipline. Nuk ka të paraparë projekte për biznese që rritin vende të punës. Me vjenë mirë që komuna ka paraparë rregullimin e tualeteve publike për fshatin Radavc, për të ju kujtuar sepse në qytet nuk kemi tualete publike. Objekti i administratës në Vitomericë janë paraparë mjete në

vlerë 200.000 euro. Cilat shërbime do të ofrohen dhe nese ofrohën shërbimet e deri më tanishme pse gjithë ky investim? Janë paraparë 40.000 euro për trupin e teatrit ne vit subvencione, nuk e di sa shfaqje teatrale kemi në vitë, por ndoshta edhe nuk mjaftojnë këto mjete, po jo të ndajnë mjete dhe mos të kemi shfaqje. Shtëpia e komunitetit për persona të moshuar, kush do ta menaxhojë këtë institucion apo do të jetë një partneritet publiko-privat! Duke shiqur strukturën e shpenzimeve për vitin 2025 nepër komuna, me ranë në sy shpenzimet e komunës së Pejës dhe komunës së Gjakovës, duke e ditur që janë me numer të banorëve të njejtë. Komuna e Pejës për mallra dhe shërbimeve ndan 5.297.000 euro, ndersa komuna e Gjakovës 4.670.000 euro, dallim rreth 600 mijë euro me pak. Tek investimet kapitale komuna e Pejës 13.481.658 euro, ndersa Gjakova 14.742.931 euro, rreth 1 milionë e 300 mijë euro Gjakova me shumë, ndoshta kryetari kish mujtë me na dhënë një shpjegim!

**Kryetari Z. Gazmend Muhaxheri:** Eshtë mirë që i berë këto krahasime, sepse kur keni qenë pushtet i keni qit prej punës 285 pastruës roje dhe puntorë të gjëlberimit. Për atë arsye komuna e Pejës është e vetmja prej komunave në Republikë të Kosovës që 2 milion të mallrave dhe shërbimeve i ndan për me ju dhënë rrogat këtyre puntorëve, dhe mandej as Ferizaji as Gjakova nuk mund të krahesohet me Pejën, sepse janë 2 milion që ski ku i mer. Për përfaqësim të avokaturës, vetëm një lënd që e kemi fituar tash i bjen 600 mijë euro, që e kan mbojtë këto tri avokate që i ka marrë komuna e Pejës, do të thotë jemi shumë mirë me përfaqsim të avokatëve. Tek projekti për qender ka të bejë me ndarjen e buxhetit për qender për fëmijë, për të cilën na ka obliguar ministria me i nda edhe 10 vende të punës, ende nuk ka treguar, çfare njerëz me punësu. Por ministria mirëqënies, 10 vende të punës janë marrë nepër drejtorit tjera dhe është ndarë ky buxhet, për qëndren me i trajtu fëmijet 2-3 ditë që largohen prej familjës për me pasë ku me qendru.

**Znj. Hidajete Nikqi:** Unë e di se kam menaxhuar një institucion shëndetsorë, dhe ne kemi pasë të privatizim shërbimin e sigurimit. Për një kohë shumë të shkurtë, gradualisht të gjithë i kemi kthyer në puntorë të rregullt të spitalit, do të thotë që 12 vite qeverisje tende, edhe ne qeverisjen tonë që edhe ti ke qënë bashkëpuntorë edhe puntorë shumë i ngushtë, edhe nënretar një kohë, por gjithmonë po thirrësh për ne. Ju që po punoni mirë pse nuk betë zgjidhje?

**Kryetari Z. Gazmend Muhaxheri:** Ne e kemi berë zgjidhjen, për dallim prej juve, që i keni punsuar 70 vetë në administratë, i keni largu 280 puntorë të pastrimit. Unë, ata njerëz nuk kam mundur mi largu më prej punës. Kjo është përgjigjja e saktë, mandej kur kemi përplasje politike flasim për të gjitha.

**Z.Naim Bytyqi:** Fillimisht po kërkojë nga kryetari Gazmend Muhaxheri, të deklarojë së kush është shpijuni këtu, pasi në jemi 45 persona prezent, ose në të kundertën nese nuk mundet me gjetë shpijunin të paktën le të na kërkojë falje! Ose kërko falje ose qite shpijunin me emer e mbiemer, se cdo seancë shpijuni, shpijuni i ka ardh koha me ditë kush është ktu shpijuni! Edhe këtë planifikim buxhetor të vitit 2025-2027 është tu e pëcjellë shumë ndryshime, sa i përkëtë ndërrimit të invesimeve, largimit të disa invesimeve, shtyrjen e disa investimeve të tjera. Ka

investime të cilat janë paraparë në planifikimin 2024 dhe janë shtyer deri në 2027. Siç e dimë ne të gjithë buxhetit vitit fiskal vjen edhe korniza afatmesme buxhetore, ku vetëm një herë kontrollohen dhe disa projekte ndryshohen, sepse është e drejtë ligjore që të investohet në ato projekte të cilat janë të nevojshme. Unë, desha t'i numerojë disa projekte të cilat janë shtyer nga projekti i vitit të kaluar: Implanti për ujrën e zeza në fashtin Trestenik, Implanti për ujra të zeza në Kuqishtë, Sheshi "Shkelzen Haradinaj", Blerja dhe ndertimi i ashensorëve, Nderimi i deponisë në fshatin Sferrkë, këto janë shtyer unë e di që ka sanksionet për këtë temë, mirpo unë mendoj që këto mjete nuk është dashtë me u largu. Meqenëse sanksionet të ardhmen mundën me u largu, atëherë nuk ka qysh e bën zotimin e mjeteve. A mundet dikush me na tregu se si ka mundësi me u heq mjetet e kësaj deponie, kur unë kam cekë edhe herën e kaluar që kjo deponi është mollë shërr për të gjithë banorët e rrafshit të Dukagjinit, është deponi e rezikëshme dhe mund të shkaktojë edhe vdekjen e banorëve. Pikë tjetër është projekti i Drinit të bardhë që ka qënë për 2025, është shty për vitin 2026. Ndërtimi i objektit për persona me aftësi të kufizuara ka qënë projekt për 2024 është shty për vitin 2025, e tash është shty për vitin 2026. Ndërtimi i qerdhes në Radavc edhe ky projekt është shty për vitin 2026. Ndërtimi i palestres në fsh.Llozhan, fsh Qyshkë, fsh.Kryshec, fsh.Trestenik, për të gjitha këto projekte janë parapa kah 200 mijë euro, të gjitha janë shtyer dhe disa edhe janë hequr krejt. Nese e shikojmë me vemendje këtë planifikim buxhetor 2025-en i tërë është karakterit elektoral edhe pse so du me bo politikë, por pse e them elektoral është bënë buxheti se qysh me ja shtu dikujt një oborr, një dritë ndriqese sa me muajt me bind për ndonjë votë . Unë, mendoj që buxheti duhet të bartet atje ku janë duke u bart banorët, sepse banorët janë duke pësuar levizje të mëdha emigrim jashtë vendit, emigrim nga fshatrat në qytet. Qyteti është ngarku komunikacioni është ngarku por ka edhe investime të cilat duhet me u drejtu rreth qytetit! Unë, mendova njëherë që po i mungon një fletë materialit, sepse asnjë investim për qytetin nuk po shihet, mirpo kur e pash nuk ka asnjë investim serioz. Ftoj ekzekutivin dhe kryetarin e komunës që investimet të i drejtoj aty ku shkojnë banorët me shku edhe investimet. Andaj une pa desht me ofendu dikend Peja me të vërtet është në duar shumë të kqija dhe në qeverisje të keqe, andaj ky buxhet nuk e meriton qeverisjen dhe kjo qeverisje nuk e meriton kuvendin!

**Znj. Hidajete Nikqi:** Meqenëse jemi të pika e planifikimit të buxhetit, për mos me i përsërit disa prej çështjeve që u përmenden edhe me herët. Unë kam pritur që në këtë planifikim të shoh disa prej nevojave kryesore që i kanë qytetarët, kam kërkuar edhe me herë që të jetë një çerdhe në Lugun e Baranit, unë e pash që çerdhja do të ndertohet në Zahaq, por ne e kemi bisedu edhe këtu dhe kryetari na ka premtuar që ndonjë prej shkollave do të riaktivizohen dhe do të kthehen në çerdhe, për shkak që edhe numri i nxënësve është në rrahje. Poashtu nuk pashë ndonjë investim që do të bëhet në fshatin Vranoc, qoftë ndërpremtja e disa kanalve që nuk janë përfunduar, poashtu e kam edhe një pyetje sa i përket shpenzimeve komunale ,tek administrata e arsimit shohë që tek furnizimi me ujë për vitin 2025 është 71.500.00 euro, për vitin 2026 prap është 71.500.00 euro, ndersa për vitin 2027 e shohë që është 33.000.00 euro. A është për shkak të humbjeve të cilat do të jenë tek ujësjellësi, apo për çfarë arsye? kërkoj nga ju që të na tregoni në lidhje me këtë.



**Z. Nezir Jahmurataj:** Kryetari u ankua që për krye të banorit qeveria po i ndan para pak. Veç është mirë kryetar edhe ti sa kanë banorë të gjitha bashkësit lokale edhe fshatrat me i nda sepse je i zoti i shtëpisë për 4 vite. Unë e di që Lybeniqi 1800 banor i ka, për kry banori i ki gati 15 milion shpenzime kapitale, nuk e pashë askund që figuron Lybeniqi, Lybeniqi asgjë mos qoftë, janë 60 familje që ju ka humb një ose dy antarë të familjës në luftë. Varrezat i kemi ndërtuar vetë, ujësjellësin vetë, lapidarin vetë, të paktë ato që i kam kërkuar që 2-3 vite. I ke harxhuar tek bjeshka e Jerzniqit 20.000 euro, asgjë nuk është berë. Lidhje bjeshkën e Strellcit më të Lybeniqit shkojnë për gjysëm ore 25.000 -30.000 euro. Që 3 herë e kërkojë sepse është lehtë me shku për qytetarët, turistet dhe për të gjithë tjerët. I kam propozuar disa projekte, shtëpin e fshatit e kam kërkuar vitin e kaluar, nuk është hiç dhe nuk e shohë askund. Pastaj e kam kërkuar një trotuar, as ky nuk figuron hiç. Rrethë rrotullimi po besojë që ka mu nisë rruga me 4 traka Pejë-Deqan. Tani dua të ndalëm tek shpenzimet, e kam parë drejtorin për shërbime publike, ne një vend 460.000.00 euro ndriqim. A e dini sa janë 460.000.00 euro për ndriqim? Pastaj po e shohë që po ndërtohet wc publike në Radavc, në rregull, por shikone parkun e qytetit që shkojnë pleqtë e sportista. Ka edhe shumë tjera por kaq kisha!

**Znj. Eleonora Balaj:** Unë kam një kërkesë tek kujdesi primar shëndetsorë, që buxheti i planifikuar për këto 3 vite, të shfrytëzohet për të gjithë puntorët e këtij shërbimi njejtë, sepse po shihet që ka tendenca ti bëhet mirë dikujtë që i takon partisë në pushtet, kurse për të tjerët jo. Për shëmbull me mujë kemi punuar me një pulsooksometër, i cili kushton shumë pakë, glikometer nuk kemi farë, po e shohë që janë ndarë vetëm për vitin 2025, 118.000.00 euro që do të thotë është një buxhet i mirë, në anën tjetër mirëmbajtja e ndërtesave shëndetsorë, poashtu është ndarë një buxhet i mirë. Ka ordinanca ku puntori shëndetsorë që nuk i takon partisë në pushtet e ka ordinancën 10 vite të pa lyer, kshtu që mendojë buxheti i planifikuar duhet të shpërndahët njëjt për të gjithë sepse të gjithë janë puntorë të këtij institucioni.

Nga të gjithë anëtarët prezent me 20 vota pro, 11 vota kundër, 1 përmbajtur, 1 antarë nuk ka marrë pjesë në votim, miratohet projekt buxheti për vitin 2025-2027.

**5.Shqyrtimi dhe miratimi i propozimit të Kryetarit të Komunës për këmbimin e pronës së paluajtshme Komonale me pronën private të z. Fatmir Zymberi, me qellim të përmbushjes së interesit publik.**

**Kryetari Z. Gazmend Muhaxheri:** Po flasë për të dy pikat 5 dhe 6 sepse është i njejt problem. Kur është ndërtu shkolla “ Skender Qeku” në Qyshk, kësaj familjës Sefa dhe Zymberi i është marrë hymja dhe është ndërtuar hymja e shkollës. Kur është ndërtuar kjo para 15-16 viteve, do të thotë është problem që duhet me zgjidh për shkak të pronës. Familja Zymberi i merr një pjesë të oborrit të shkollës, nuk e di a janë dakorduar atehere apo si është kryer kjo punë, dhe familja Sefa një pjesë të oborrit të shkollës po leshohet hymja e shkollës,do të thotë parcella 92-15 dhe parcella tjetër 92-13. Eshtë riregullim dhe ndihmesë që këto familje me zgjidh problemin e tyre pronësorë juridik që e kanë. Tash prona ku i kanë shtëpit e tyre, bëhen prona private të tyre dhe hymja e shkollës bëhet zyrtarisht hymja e shkollës dhe e përfundojmë këtë problem.

Nga të gjithë anëtarët prezent me 20 vota pro, 5 kundër, 5 përmbajtur, 3 antarë nuk kanë marrë pjesë në votim miratohet i propozimi i Kryetarit të Komunës për këmbimin e pronës së paluajtshme Komunale me pronën private të z. Fatmir Zymberi, me qëllim të përmbushjes së interesit publik.

**6.Shqyrtimi dhe miratimi i propozimit të Kryetarit të Komunës për këmbimin e pronës së paluajtshme Komunale me pronën private të znj. Ajmon Sefa, me qëllim të përmbushjes së interesit publik.**

Nga të gjithë anëtarët prezent me 20 vota pro, 5 kundër, 6 përmbajtur, 1 antarë nuk ka marrë pjesë në votim, miratohet propozimi i Kryetarit të Komunës për këmbimin e pronës së paluajtshme Komunale me pronën private të znj. Ajmon Sefa, me qëllim të përmbushjes së interesit publik.

**7.Shqyrtimi dhe miratimi i propozimit të Kryetarit të Komunës për këmbimin e pronës së paluajtshme Komunale me pronën private të z. Sali (Shaban) Qelaj, me qëllim të përmbushjes së interesit publik.**

**Kryetari Z. Gazmend Muhaxheri:** Eshtë ndërrimi i parcellës të komunës me pronarin Salin Qelaj, është përballë qarshi xhamisë. Komuna e jep pjesën që është përballë qarshisë, ndërrimi i sipërfaqeve është 33 metra me 33 metra. Kjo punë është nga 2010, në vitin 2010 ka pasë një kontest gjyqësorë, kontesti gjyqësorë ka përfunduar dhe është i vetmi dyqan që nuk është rregulluar në qarshi. Po shpresojmë që me rregullim të kësaj punë përfundon edhe ky dyqan dhe përfundohen të gjitha procedurat që janë të parapame me qarshin e gjatë.

**Z. Berat Ganiqi:** Po kërkojë sqarim nga kryetari, z. Salihu këtë pronën që po don me e këmbi, kur e ka ble dhe me çka meret? Tregoj asambleistave dhe qytetarëve. Po ju tregoj unë që në bazë të fletës poseduese po del që ky është bërë pronar në vitin 2024, në bazë të një marrëveshje të ndërmjetsimit, dhe interesant këmbimi po ndodhë në 2024, 3 muaj pasë marrëveshjes së ndërmjetsimit dhe po fillojnë procedurat e këmbimit dhe ky merrët me ndërtim. Këto janë biznese, në këtë rast kështu kaq flagrant, a është bërë drejtorja e çështje pronësore zyre për ndërmjetësimin e pronave, a çka është bo? Ku po i gjeni këta njerëz? Kjo është vetëm ndërmjetësimin e pronave nese është hap ndonjë zyre për patundshmëri, qatë e ki.

**Kryetari Z. Gazmend Muhaxheri:** Cka do që ki shkon e lajmëro prokurorin, i ki të gjitha dokumentet. Kjo është e bërë në bazë të planit të qarshisë së gjatë, prona thash që është prej 2010 në kontest gjyqësorë, ka dalë në emër të personit, ka shku në drejtorinë për monumente dhe i kanë thënë nuk mundësh më ndërtu objektin pa e ndërru pronën. Ne jemi servisë i qytetarëve, ne hetuesi nuk jemi, të gjitha dokumentet i ki këtu, kanë shkuar në ministri, janë vlerësu dhe çka ka të pa qartë ja dergoni prokurorit dhe ai merrët më këtë punë. Eshtë i vetmi dyqan që nuk është rregullu 24 vite pas luftë, ai person që e ka ble këtë pronë lyp zgjedhje e zgjedhja është që jemi detyru ne me ja ndërru pronën dhe jo pse kemi qef. Ministria e kulturës e ka paraparë që rruga

duhet me u zgjëru dhe me u ngushtu në anën e kundërt. Kush e din atë vend në qarshi e kupton pse është bërë kjo punë dhe është e bërë me projekt të qarshisë së gjatë!

**Z. Berat Ganiqi:** E para nuk ka nevojë për arsytim dhe lëndët në prokurori nuk i dergojë pa i bo publikisht. Këtë e kam berë publikisht gjithë jetën, se kur i dergojë lëndët në prokurori kthim mbrapa nuk ka. Nuk kam dergu deri tash për shkakë që kur unë e di që atë lënd e humbi nuk shkojë. Mjerë për atë prokuror dhe mjerë për atë tjetrin që qenka duke e thirrë në telefon 10 herë dhe qenka duke i thenë prokurorit, shko kryje punën tendë. Tash a prokurori është politikisht e po të shprijonon ty, a ti po e ndëgjon atë, njerën këtu spo e di, por nuk ish dashtë ti me e ditë këtë muhabet nesë 10 herë e kan thirrë prokurorin. Çeshtja e dytë është që në këto kembime të pronave, ma shumë janë duke fituar biznismenat se qytetari. Sa për kushëri mundesh me hy nga fillimi e deri në përfundim, nese e gjën vetem një përsone, ose që të kam ardh në komunë për ndonjë interes personal, këtu më ke, urdhëro trego. Nuk jam unë prej atyre opozitarëve që kur e kam interesin votojë pro, e kur nuk e kam interesin votojë kundër, sepse e din shumë mirë në lagjën time, kur e kam pasë interesin ma të mirë, të kam votu kundër.

**Kryetari Z. Gazmend Muhaxheri:** Këtu njeri nuk po mundet me fol as figurativisht, do më thënë policia, prokurori, janë thirrë brenda ditës 10 herë për me vepru, për me ja ndalë punën operatorit i cili ka qënë në përfundim të punës. Po të tregojë se ne në Pejë jetojmë, nuk jemi tu jetu në bjeshk dhe jam kryetar komune, kam informata me shumë se ai shërbimi informativ që e keni kriju ju. Jam kryetar komune e njerëzit vin me të tregu. Për shumë njerëz jam pikë shumë e besueshme dhe për këta që vin mi ndërru sepse kan hall. Sikur ky rasti me këto 2 minoritete, 14 vite nuk është marrë askush me ta, pronën e tyre ja'u kanë mbaru hymjën e shkollës. Për këtë arsye po them, njerëzit vinë të unë me zgjidhë problem. Tash 89 persona janë duke prit në rend, për me ndërru, unë e di që edhe 3 muaj kemi kohë, por se kam ndermend me u ndalë kurr. Për secilin rast kan thenë ka marrë para kryetari e kanë dërgu në prokurori, nuk merrem më atë punë hiq. Figurativisht ka plotë këtu që folin ose votojnë kundër, e mandej kur të ju vjen ndonjë kushëri i tyri bën me ndërru. Nuk e ndërrojmë për kushëri, por e ndërrojmë për interes publik. Nuk mundesh me i ik kësaj punë, kjo është obligim ligjor që detyrohemi me e kry ne si komunë që jemi në shërbim të qytetarëve.

Nga të gjithë anëtarët prezent me 18 pro, 10 kundër, të përmbajtur nuk ka, 4 antarë nuk kanë marrë pjesë në votim, miratohet propozimi i Kryetarit të Komunës për këmbimin e pronës së paluajtshme Komunale me pronën private të z. Sali (Shaban) Qelaj, me qellim të përmbushjes së interesit publik.

#### **8.Shqyrtimi dhe miratimi i propozimit të Drejtorisë se Administratës dhe Kryetarit të Komunës së Pejës për kompensimin e kryesuesve të Këshillave Lokale për vitin 2023 dhe 2024.**

**Kryesusi Z. Rexhep Kurtbogaj:** Me udhëzime administrative për ligjin për këtë qeverisje lokale kanë qenë të precizime, pagesat për këshilla lokal në bazë të mundësive buxhetore të

komunës, ndërsa me ligjin e pagave nuk është paraparë pagesa për komitetet tjera përveç komiteteve obligative. Në konsultë të vazhdueshmë me ministrin e administrimit të pushtetit lokal, kemi kërkuar se si me gjetë rrugën dhe në takime që kemi pasur më partnerët tjerë, asociacioni e komunave, grupin e kryesuesve dhe drejtorëve të administratës, e kemi marrë një sugjerim që komuna e ka mundësin prej mallrave dhe shërbimeve, atëherë e kemi shfrytëzuar rastin për këshilla lokal, për KKSBB dhe për trupa të kuvendit, të marrim vendim në kuvend për kompensimin e këtyre për punën që e bëjnë. Kryetarët e këshillave lokal obligohen që 6 takime ti mbajnë brenda vitit me listë të nënshkrimeve dhe më proces verbale. Është caktuar një shumë 300 euro në vitë, është një shumë solide që një pjesë të shpenzimeve të aktivitetëve të tyre ja'u kryen.

Nga të gjithë anëtarët prezent me 26 vota pro, kundër nuk ka, 1 përmbajtur, 5 antarë nuk kanë marrë pjesë në votim, miratohet propozimi i Drejtorisë së Administratës dhe Kryetarit të Komunës së Pejës për kompensimin e kryesuesve të Këshillave Lokale për vitin 2023 dhe 2024.

### **9.Shqyrtimi dhe miratimi i propozimit të Kryesuesit të Kuvendit të Komunës së Pejës për kompensimin e Komiteteve Konsultative për vitin 2023 dhe 2024.**

**Kryesusi Z. Rexhep Kurtbogaj:** Gjatë vitit 2023 komitetet konsultative dhe komitetet tjera kanë mbajtur takime të cilat i kanë dërguar proces verbalët dhe pjesëmarrjen në takime në zyre të kuvendit. Komitetet do të paguhet për 6 takime brenda vitit, fjala është për vitin 2023 dhe 2024 më shumë 50 euro.

**Z. Nezir Jahmurataj:** Njëri prej antarëve të komiteteve jam edhe vetë, nga viti i ri një mbledhje e kemi mbajtur, 2 antarët që komuna na i ka sjell, janë tërhequr, komuna nuk i zëvendësoi, se fundim është tërhequr edhe z. Naim Bytyqi, se fundim edhe kryetari i komitetit, unë nuk e di çka me bo, a mu tërhequr edhe unë. Unë kom besoj që më këto komitet kemi më bë një punë të mirë por nuk mbërrim deri në fund.

**Z. Islam Husaj:** Nesë e aprovojmë këtë vendim, atëherë duhet të jetë vendimi për komitete konsultative dhe komitetet tjera, për ato që i kanë plotësuar kushtet kuptohet. Sa i përket raporteve, kemi kohë për vitin 2024 të dorëzohen deri në fund të muajit tjetër. Deshta me sqaruar se me nxiti fjala e parafolësit, kolegut tonë Z. Nezir, nuk janë komitetet kontrollë e ekzekutiv, nuk kanë çka me kontrollu, ata kanë më e këshillu ekzekutivin, kanë me i pa cilat janë objektivat e drejtoratit pastaj me i tregu se si mundën me mirë me i krye ato punë. Për këtë arsye mendoj që disa arsye e kanë plotësuar atë kriter, disa kanë mendu që janë ekip që kanë me shku me i kontrollu drejtoratin, se çka dhe si po i kryejnë punët. Vetëm desha me sqaruar këtë sepse nuk po kuptohet drejtë roli i komitetit, në udhëzim administrativ është e përcaktuar se cilat janë detyrat dhe kompetencat e komiteteve.

**Z. Naim Bytyqi:** Unë tek çështja e pagesave e pata qellimin me pasë përputhje me proces verbalë, por atë e thekësi, diçka tjetër nuk kam, mos të dalin pagesa përdersa nuk kemi punuar, e di që nuk dalin pasi shihen proces verbalët, por mos të kemi mos përputhje.

**Z. Nezir Jahmurataj:** Faleminderit Z. Islam që na mëson, ne e dim që nuk jemi komitet vendimmarrës, ne jemi sugjerues, bashkëpunorë, gjithmonë kemi mbajtur mbledhje mirëpo u ndalën, shkaqet janë tjera. Ne nuk kemi me kontrollu, por kemi me bashkëpunu që drejtorja e urbanizmit dhe ambientetit me u rregullu sa ma mirë.

Nga të gjithë anëtarët prezent me 29 vota pro, kundër nuk ka, 1 përmbajtur, 2 antarë nuk kanë marrë pjesë në votim, miratohet propozimi i Kryesuesit të Kuvendit të Komunës së Pejës për kompensimin e Komiteteve Konsultative për vitin 2023 dhe 2024.

#### **10.Shqyrtimi dhe miratimi i propozimit të Kryetarit të Komunës së Pejës për kompensimin e anëtareve të KKS-së për vitin 2023 dhe 2024.**

**Kryesusi Z. Rexhep Kurtbogaj:** Gjithashtu edhe për këtë trup është fjala që të paguhen antarët që kanë marrë pjesë në takime, duke u bazuar në proces verbalin e takimeve prej 2 viteve do të thotë pra 2023 dhe 2024.

Nga të gjithë anëtarët prezent me 30 vota pro, kundër nuk ka, përmbajtur nuk ka, 2 antarë nuk kanë marrë pjesë në votim, miratohet propozimi i Kryetarit të Komunës së Pejës për kompensimin e anëtareve të KKS-së për vitin 2023 dhe 2024.

#### **11.Shqyrtimi dhe miratimi për dhënie në diskutim publik të Draft –Planit të Veprimit kundër braktisjes dhe mosregjistrimit të shkollës, 2024-2026.**

**Z. Islam Husaj:** Kisha kërku nga zyra e kuvendit që ne si antarë të kuvendit më na njoftu për datën dhe orën e diskutimit publik.

Nga të gjithë anëtarët prezent me 30 vota pro, kundër nuk ka, përmbajtur nuk ka, 2 antarë nuk kanë marrë pjesë në votim, miratohet Draft –Planit të Veprimit kundër braktisjes dhe mosregjistrimit të shkollës, 2024-2026.

#### **12.Shqyrtimi dhe miratimi për dhënie në diskutim publik të Draft Rregulloren për Sherbimin e Transportit me Marimangë në territorin e Komunës së Pejës.**

**Z. Labinot Panxha:** Unë pasi e kam pranuar materialin jam munduar sado pak me e analizu këtë rregullore dhe me kontribu me vëretjet dhe sugjerimet e mija në menyrë që me dalë sa ma mirë. Kjo draft rregullore është përpiluar në një ligjë i cili është shfuqizuar dhe është zvendësuar me ligjin 08/L-186 për rregullat e trafikut rrugorë, pra kjo rregullore do të duhej të thirrëj në këtë ligjë, i cili tash është në fuqi dhe ky ligj parashih që me këtë rregullore të përcaktohet vetëm pllaci ose vendi ku ruhen veturat, të cilat shvendosën pasi e kanë bllokuar ndonjë prej hyrjeve të cilat cekën në këtë ligj. Gjithashtu në këtë rregullore është përcaktuar edhe tarifa me nenin 93 që thotë shumën e shpenzimeve për zhvendosjen e mjeteve e përcakton policia me ministrin përkatëse të financave që do të thotë komuna nuk ka të drejtë të përcaktojë rregullore. Prandaj unë i kam dhënë disa vëretje dhe sugjerime në lidhje me këtë përpilim të kësaj draft rregullore, të njejtën do të ja dorëzoj personalisht drejtorit Z. Agronit dhe po ofroj bashkëpunim në menyrë që më dalë

sa më mirë kjo rregullore. Unë kisha kërku që edhe një herë me e analizu ju këtë rregullore, kur të qitet ne diskutim publik sigurisht që ka më pasë edhe vëretje prej qytetarëve të cilët kanë me marrë pjesë dhe i njëjti të përpilohet me ligjin të cilin e ceka.

**Z. Berat Ganiqi:** Unë vetëm i ndaj shqetësimet dhe pa dyshim ka me qënë një rregullore që kam më e pëcjell gjatë gjithë kohës. Shqëtesimi im është në komitet për politik dhe financa që thashë së pari mos me i blloku veturat, mos me qënë ajo praktika që ka qënë më herët dhe e dyta që është shumë më rëndësi është së kush e mer këtë kompani me menaxhu, duhët më ju shmangë konfliktit të interesit komplet. Mos të jëtë ndonjë polic që e bën edhe qytetarëve në oborr shkojshin ja'u qitshin bllokadat. Unë jam kundër bllokadave dhe këto bllokada duhët me u hek, për shkakë që ma mirë është me e marrë veturën krejt marimanga, e dinë që se ki veturën aty, se sa më ta blloku dhe me shpresu që e ki veturën aty dhe më të dalë ndonjë rast në familje semundje, apo diçka tjetër mos me mujtë as me lëvizë me atë veturë. Plus sanksionet tjera që kanë qenë denimet, përposë që të denojkë me gjobë, këta ta jepshin edhe një gjobë tjetër 25 euro për heqje të bllokadës, dikush që nuk e ka parë bllokadën e është nisur përfundonte në prokurori si i dyshimt, e hetojshin për prishje të asetit shtetëror. Andaj duhet me pasë shumë kujdesë këto bllokada mos me kalu.

Nga të gjithë anëtarët prezent me 29 vota pro, kundër nuk ka, pëmbajtur nuk ka, 3 antarë nuk kanë marrë pjesë në votim, miratohet diskutim publik të Draft Rregulloren për Sherbimin e Transportit me Marimangë në territorin e Komunës së Pejës.

### **13.Shqyrtimi i informatës nga DKA për fillimin e vitit shkollor.**

**Znj. Hidajete Nikqi:** Sa i përkëtë informatës për fillimin e vitit shkollor, unë do ti kisha dhënë disa këshilla, së pari informatat të jenë pak më të detajuara, sepse nuk janë të paraqitura si ka qënë gjendja e shkollave në këtë fillim vit, pastaj sa i përkëtë furnizimit me tekste shkollore, e kisha dhënë si këshill që drejtoria e arsimit të jetë në bashkëpunim me MASHT-in, dhe të kërkojë që për funzimin më librat bashkë më shtëpitë botuese të hapën pikat tjera, në mënyrë që të ken mundësi nxënësit për tu pasjitur me libra.Sa i përkëtë këtij furnizmi pse ka ndodhë kjo në komunën tonë ose në përgjithësi, është çeshtja tek shtëpit botuese, shtëpit botuese nuk i kan shitë librat ose tekste tjera. Poashtu sa i përkëtë këtij fillimi të këtij viti shkollor, një këshillë tjetër është që të jenë kokurset me kohë, në mënyrë që nxënësit mos ta pësojnë për shkak të mosmbatjës së orëve mesimore. Kisha kërku poashtu që shkollat të kënë logoped, poashtu ne disa shkolla edhe klasë burmiore është këkesë dhe nevojë që këto klasë të pajisen me materiale shpenzuëse dhe materiale didaktike.

**Z. Berat Ganiqi:** Vazhdon fëmijëve të ju kërkojë nga 1 euro për alarm, 1 euro per sigurim dhe të holla të ndryshme për shkakë të kushtëve të cilat nuk janë të plota në shkollë. Arsimtarët nuk kan fajë, kujdestarët nuk kan fajë sepse me atë pagë që kanë nuk munden me i mbulu ato shpenzime, mirëpo ky është realiteti. Poashtu është edhe një çeshtje pak e nderlikume por të cilën duhet me e ngritë, është rasti i fundi i cili ndodhi në Pejë, sot nuk jam duke folur ne emër të

askujt, pos në emër timin, unë me besim jam musliman, por jo praktikues i fesë. I bëj thirrje secilit drejtor në Pejë siç ka qënë rasti në “Asdren” e ai fëmi vazhdon me e ndjek mësimin, le të vazhdojë njëjtë. Nuk kemi nevojë për spektakel, le ta dallojmë së kush e vesh uniformën fetare prej shamisë. Të drejtat duhet me i pasë të gjitha të barabarta, e drejta në arsim është e garantuar me kushtetutë dhe nuk keni nevojë për spektakel!

**Z. Mentor Bajri:** Desha me e diskutu këtë problemin e librave, po flasë për lendën time që e jap muzikën, që 3 vite 3 herë është ndërru libri. Ky është një problem i madh i vazhdueshëm prej nga pasë lufta, nuk po du askend me e akuzu por është problem që duhet me u zgjedhë. Problemi nuk është tek botuesit por është tek ata që i punojnë plan programet dhe MASHT-i.

**Z. Atdhe Berisha:** Meqensë jam sekretarë i gjimnazit “ Bedri Pejani” dhe e kemi çeshtjen e kësaj vajzës që është bërë mediatike në krejt Kosovën, unë nuk mendojë që qendrimi i drejtorit është spektakël, për me tepër z. Berat duhet me i lëxu udhëzimet administrative. Ne e dimë që ka kushtetut, mirëpo në udhëzimet administrative, aktet nelnigjore e rregullojnë funksionimin e një shkollë, në këtë rast institucionit tonë. Në këtë rast ne e kemi në fuqi nga MASHT-i le të hyjë z.Berati në faqe udhëzimin 06/2014 e cila e precizon saktë, në shkolla përveç ndalesave tjera, ndalohet bartja e uniformës fetare. Spektakël nuk ka bërë drejtori por ka bërë deputetet që na kan ardhë atë ditë në shkollë dhe me çdo kusht kanë kërku me e fut në shkollë. Vetëm po du me tregu se kush ka bërë spektakël gjatë fushtave dhe që e ka perdor në fushat ( lëshon fjalimin e z. Albin Kurti gjatë fushtatës zgjedhore). Gjatë këtyre 4 vite kam premtu që kanë me ndryshu dhe ende vazhdon të jetë në fuqi ai udhëzim administrativ, dhe nuk është faji tek drejtori i cili ka marrë mesazhe të ndryshme dhe kërcenime vetëm se e ka zbatuar një udhëzim administrativ që është në fuqi dhe që mbetet në fuqi nga ministri qe në këtë rast e ka LVV.

**Z. Berat Ganiqi:** Eshtë e vërtetë ajo që është premtu, gjëma ti një komunë që LVV është duke udhëheqë dhe ndonjë vajze ju ka ndaluar me shku në shkollë me shami. The udhëzimi administrativ, bjën poshtë para kushtetutës, është akt nënligjorë bjën posht para ligjit. Të drejtat e njeriut mund të kufizohen vetëm me ligj jo me udhëzime administrative. Udhëzimi administrativ thotë uniformën fetare, uniformë fetare ka hoxha e prifti, ajo nuk ka ardh aty me kry shkollën për hoxhë, kuptone uniformën fetare çka është.

**Z. Naser Gega:** Lidhur me fillimin e vitit shkollorë kisha bërë thirrje secilit prej nesh këtu ti hapim rratht koncentrik në rrethin ku jemi sepse shkolla është e shejtë, duhet ti mësojmë fëmijt dhe nxënësit tonë të jenë konformë në rregull. Pos tjerash këtë vit ka qënë marramëndesë kërkesa e prindëve, është dashtë me i barikadu kërkesat e pa kuptimta, dua në atë shkollë, dua tek ajo mësuse, dua të ajo kujdestare. Tjera është tek shkollat profesionale kanë fillu me u vlerësu, numri i nxënësve mbi 400 kanë shku ne teknike dhe ne ekonomike ka me pakë. Në të vërtetë nxënësit të cilët e kryjnë një shkollë të mesme profesionale, ai ka me u avansu për dallim prej gjimnazi që duhet me vazhdu edhe me tutje. Tek çeshtjet të cilat u diskutuan, nuk u përmenden renovimet të cilat nuk u than dhe në raport nuk i keni, këtë vit janë mbyllur 2 paralele të ndame, është paralelia e ndame në Broliq dhe paralelia e ndame në Doberdol. Eshtë duke u punuar palestra e

sportëve në Troboviq, në Glllogjan dhe në objektin B në shkollën “Rifat Gjota” është nxemja dhe sanitaria për ta bërë funksionale atë pjesë. Tek çështja e teksteve shkollore është temë që vertetë na ka shqetësuar të gjithëve, nuk ka të bëjë a pajtohemi ne a jo, por neve na mbetet me e zbatu, si drejtori komunale e arsimit në qeshor e kemi dërguar në ministri katalogin e teksteve të të gjitha shkollave të komunës së Pejës dhe atehëre vendimin e ka marrë ministria për mu nda sikur vitin e kaluar. Sa i përkëtë konkurseve, kemi hap konkurse vazhdimisht me kohë për aq sa kemi mundur, mirëpo në të njejtën kohë po ndodhin situata që ne nuk po na pyesin hiq. Tek logoped në shkolla, kemi mbush kuotën e nxënësve, mirëpo në të njejtën kohë na është kufizuar numri dhe nuk po mundemi as asistentë as logopedë, ndërsa klasë burimore ka shkolla “Asdreni” dhe “8 Marsi”, janë të furnizuara mirë, kërkësat e shkollave për të holla të cilat janë, shkollat e din që asnjë të hollë nuk munden me kërkë pa këshillin e shkollës , në të cilin është këshilli i prindërve dhe e kan një përgjigjësi ligjore se si duhet të mbledhën të hollat, vetëm nese duhet me mbledhë të holla. Tek çështja e cila po diskutohet e shamisë, është një temë cila nuk ka të bëjë aspak me çështjet tona personale, mirëpo në momentin që kemi post, në këtë rast unë si drejtorë i DKA-së, nuk mund ta interpretojë ndryshe jashta asaj si e kuptojë dhe e kam obligim me e zbatu, ai është vullneti i saj, ka mbetë të bisedohet me shkollën ta gjejnë një gjuhë të përbashkët dhe ata që e gjejnë e kanë mbeshtetjën time.

**14.Pytjet dhe propozimet lidhur me punën e Komunës, të ngritura nga anëtarët, në atë rënditje siç jan pranuar:**

Nuk ka pasur

**15.Çështje të ngritura në mbledhje nga udhëheqësi apo nga anëtarët e Kuvendit**

Meqë u shqyrtuan të gjitha pikat e rendit të ditës e propozime tjera nuk ka pasur, kryesuesi z. Rexhep Kurtbogaj e shpalli të mbyllur këtë takim të kuvendit, në orën 12:20 h.

Video incizimi i këtij takimi të Kuvendit të Komunës së Pejës në kanal zyrtarë në Youtube.

Kliko: <https://www.youtube.com/watch?v=jlAiYALouYI>

Procesmbajtësja,  
znj. Donjeta Morina





KRYESUES I KUVENDI,  
z. Rexhep Kurtbogaj

